



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:012196  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05756157

**PAKR.nr.264/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afërdita Bytyçi - Kryetare e kolegjit, Vatton Durguti dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të ndaj të akuzuarit D.S., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.S., av. A.P., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.16/24 të datës 07.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 29.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. Aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren në raport me dënimin me burgim, ashtu që **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.16/24 të datës 07.03.2024, përkitazi me vendimin për sanksionin penal - dënimin me burgim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin D.S. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në

paraburgim prej datës 11.01.2024 deri me 07.03.2024, ndërsa dënimi me gjobë prej **1,300.00 €** (njëmijë e treqindën/euro) merret si i vërtetuar, cili do të ekzekutohet konform pasuesit të II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i pa ndryshuar.

II. Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.S., av.A.P., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.16/24 të datës 07.03.2024, **REFUZOHET** si e pabazuar.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.16/24 të datës 07.03.2024, të akuzuarin D.S. e ka shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së dhe për këtë veprë penale i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 1300 euro si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.01.2024 gjer më 07.03.2024.

Konform nenit 43 paragrafi 2 të KP është obliguar i akuzuari që dënimin me gjobë ta paguaj në 6 këste mujore, dhe atë kësti i parë për pagesë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa këstet vijuese në afat prej 30 ditëve nga pagesa e këstit paraprak.

Konform nenit 43 paragrafi 3 të KP - së nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata mund t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që 20 euro gjobë do të llogaritet barabartë me një ditë burgim. Konform nenit 44 të KP - së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që të njëjtit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 1.300 euro.

Nga i akuzuari konform nenit 267 paragrafi 5 të KP konfiskohen substancat narkotike dhe atë: Një qese plastike me substancë narkotik të llojit kokainë në peshë prej 0.58 gram, tri qese plastike me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 2.10 gram, një folie alumini me substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 0.99 gram, një thikë me boks hekuri ngjyrë e zezë, një qese plastike me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1.15 gram, si mjet i

kryerjes së veprës penale. Konform nenit 276 paragrafi 1 nën-paragraf 2.6 të KPP nga i akuzuari konfiskohet një thikë dhe një boks hekuri ngjyrë e zezë.

Konform nenit 113 të KPP-së të akuzuarit D.S. i kthehet telefoni Iphone 12 me ngjyrë të bardhë me SIM kartelë 046-...-... me IMEI ... si dhe i kthehet automjeti “...” ngjyrë hiri me targa ...-...- ..., pasi që nuk është mjet i kryerjes së veprës penale.

Të akuzuarit D.S. me datën 07.03.2024 i ndërpritet masa e paraburgimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore - paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej nga 50 euro si dhe të paguaj shumën me nga 50 euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar me qëllim që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të ashpër me burg dhe gjobë.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.S. av. A.P. për shkak të shkeljeve nga neni 387 par. 1 të KPP-së lidhur me nenin 69 par.5 të Kodit Penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj si të bazuar ankesën ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket dënimit me gjobë duke e zbritur atë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.246/2024 të dt. 07.05.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal në mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër me burgim dhe gjobë, ndërkaq ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së në të cilën seancë ka prezantuar mbrojtësi i të akuzuarit av. A.P., ndërsa nuk kanë prezantuar i akuzuari D.S., për të cilën mbrojtësi konfirmoi se i mbrojturi i tij është në dijeni për seancën e

kolegjit por nuk do të prezanton, po ashtu nuk prezantoi askush nga Prokuroria e Apelit edhe pse kanë qenë të njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi se pretendimet ankimore të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prizren dhe mbrojtësi i të akuzuarit D.S. av. A.P. dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se: **Ankesa e PH-në Prizren është e bazuar ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit av.A.P. është e pabazuar.**

### **Pretendimet ankimore**

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda në ankesë pretendon se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit pavarësisht fakteve dhe rrethanave rënduese i ka shqiptuar të akuzuarit dënimin me gjobë në shumë simbolike si dhe dënimin me burgim me mundësi të zëvendësimit të burgut me gjobë. Pra, prokurori përmes ankesës pretendon se rrethanat rënduese nuk janë në përputhje me dënimin e shqiptuar dhe nuk shihet sa ka qenë dënimi unik i shqiptuar me gjobë pasi përmendet vetëm shuma prej 1300 (njëmijetreqindën) euro, kështu që i akuzuari në raport me veprën penale që e ka kryer, është dënuar nën minimumin e parashikuar me Kodin Penal dhe ky dënim konsiderohet tejet i butë. Andaj, sipas prokurorisë, mungesa adekuate e dënimeve të shqiptuara nga ana e gjykatës ka si pasojë dëmtimin e vlerave si jeta dhe shëndeti i të rinjve, e që gjykata ka për detyrë ta mbroj atë përmes dënimeve të ashpra me burg për shitësit e narkotikëve, e po ashtu dënimi duhet të ketë efekt parandalues që kryerësi por edhe të tjerët mos të kryejnë vepra të këtilla ose të ngjashme penale. Kështu që prokuroria përmes ankesës konsideron se me shqiptimin e dënimit kaq të butë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së. Po ashtu, prokurori pretendon se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim nuk i ka arsyetuar rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit në kuptim edhe të neneve 71 dhe 72 të KP-ë për shkak të shqiptimit të dënimit si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, duke mos dhënë arsyetim në kuptim të neneve 69, 70, 71, 72 të KPRK-së përkitazi me aplikimin e rregullave të përgjithshme për matjen dhe zbutjen e dënimit si dhe kufijtë e zbutjes së dënimit. Po ashtu, sipas prokurorisë gjykata nuk ka arsyetuar faktin e intensitetit apo rrezikimit të dëmtimit të vlerës së mbrojtur ku të rinjtë më së tepërmi blejnë narkotikë duke u mashtruar dhe pastaj bëhen të varur nga narkotikët, andaj në mungesë të këtij arsyesimi nga ana e Gjykatës lidhur me rregullat e matjes

së dënimit dhe zbutjes së dënimit, aktgjykimin e ankimuar e bënë të paqartë dhe të paqëndrueshëm përkitazi me vendimin mbi dënimin. Prokuroria përmes ankesës pretendon se shqiptimi i dënimit si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është dënim tejet i butë dhe se me këtë lloj të dënimit nuk do të arrihet qëllimi i ndëshkueshmërisë pasi që në këto rrethana gjykata është dashur të bëjë trajtën e veprës penale edhe më të rëndë e kurrsesi të gjenden fakte dhe rrethana për zbutjen dhe minimizimin e kësaj vepre penale. Po ashtu prokuroria thekson se dënimi është dashur të jetë në përputhje me qëllimin që përcakton Kodi Penal i Kosovës me qëllim të preventivës që në të ardhmen vepra të këtilla ose të ngjashme të mos kryhen nga i akuzuari dhe të tjerët.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.S., av.A.P., përmes ankesës pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka caktuar drejtë lartësinë e dënimit me gjobë, për faktin se gjykata nuk ka vlerësuar drejtë gjendjes pasurore e të akuzuarit ashtu siç parashihet në nenin 69 par.5 të Kodit Penal. Mbrojtja thekson se i akuzuari jeton vetëm me nënën e tij dhe të ardhurat që realizojnë të dy së bashku dhe rritja e çmimeve e bëjnë të vështirë pagesën e gjobës së vendosur nga gjykata.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, apo shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesat e prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit nuk kontestohet as gjendja faktike në këtë çështje penale, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, e që në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore konform nenit 383 par.2 të KPP-së, ngase i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale për të cilën gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari andaj, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore të paraqitura nga prokuroria dhe mbrojtësi i të akuzuarit përkitazi me vendimin për sanksion penal.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e Prokurorisë Themelore në Prizren vetëm në drejtim të dënimit me burgim (*pasi që për veprën penale parashihet dënim kumulativ, dënim me gjobë dhe burgim 2 deri 8 vjet*), është e bazuar ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.S., av. A.P., për një dënim me gjobë më të ulët se ai i shqiptuar me aktgjykimin e ankimuar, nuk është e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së ashtu që në raport me të pandehurin D.S., si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike dhe pendimin e thellë, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh llojin dhe sasinë e narkotikut të gjetur, ku kemi të bëjmë me substancë narkotike të llojit kokainë dhe marihuanë - bimë narkotike të cilat sipas Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekursor-Ligji nr.02/L-128, bëjnë pjesë në shtojcën-tabelën I, bimët, barnat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë, mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila substancë - kokainë i është gjetur në automjetin e tij dhe nën çorape të tij e më pastaj substanca narkotike marihuanë edhe në shtëpinë e tij, faktin se përdorues të narkotikëve janë kryesisht të rinjtë e që ndikon negativisht në zhvillimin e tyre duke shfaqur rrezikshmëri për tërë shoqërinë si dhe faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer për përfitime personale, pasi që shitja e këtyre substancave në treg do t'i sillte përfitime të mëdha materiale, me bindje se dënimi është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi dënimit i paraparë me nenin 38 të KPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se, pretendimet e prokurorisë lidhur me vendimin mbi dënim janë të bazuara, kjo për faktin se rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë siç janë: pranimi i fajësisë, gjendja e dobët ekonomike dhe pendim i thellë, kurse në anën tjetër si rrethana rënduese vlerësoi llojin dhe sasinë e narkotikut të gjetur, ku kemi të bëjmë me substancë narkotike të llojit kokainë dhe marihuanë - bimë narkotike të cilat sipas Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekursor-Ligji nr.02/L-128, bëjnë pjesë në shtojcën - tabelën I, bimët, barnat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë, mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila substancë - kokainë i është gjetur në automjetin e tij dhe nën çorape të tij e më pastaj substanca narkotike marihuanë edhe në shtëpinë e tij, faktin se përdorues

të narkotikëve janë kryesisht të rinjtë e që ndikon negativisht në zhvillimin e tyre duke shfaqur rrezikshmëri për tërë shoqërinë si dhe faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer për përfitime personale, pasi që shitja e këtyre substancave në treg do t'i sillte përfitime të mëdha materiale, me bindje se dënimi është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur me shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarit rrethanat e tilla nuk justifikojnë një dënim të tillë, të burgimit në kohëzgjatje prej 6 muaj e më pas në kuptim të nenit 44 këtë dënim i ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.300 euro, të shqiptuar në aktgjykimin e ankimuar nga gjykata e shkallës së parë, ngase ashtu si me të drejtë thekson prokuroria në ankesë, se rrethanat rënduese nuk janë në përputhje me dënimin e shqiptuar andaj sipas bindjes së këtij kolegji janë mbivlerësuar e që ka rezultuar që të caktohet një dënim më i butë i përcaktuar për veprën penale. Në aktgjykimin e ankimuar nuk është bërë një peshim objektiv i të gjitha rrethanave të cilat ndikojnë në matjen e dënimit duke i mbi peshuar kështu vetëm rrethanat lehtësuese në përcaktimin e dënimit që ka rezultuar në një vendim me dënimin që nuk i përgjigjet arritjes së qëllimit të dënimit.

Gjykata e Apelit duke i rivlerësuar të gjitha rrethanat e konstatuara për matjen e dënimit nga gjykata e shkallës së parë, e duke marrë për bazë mënyrën e kryerjes së veprës penale, sidomos llojin (kokainë) dhe sasinë e narkotikut, e me aplikim të dispozitës së nenit 71 par.1 nënpar.1.3 dhe 72 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, që është shëndeti i të rinjve, me bindjes se me këtë dënim do të ndikoj në parandalimin e kryesit për kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, e me të cilën dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Ndërsa në raport me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit gjykata gjen se ankesa është e pabazuar për faktin se gjykata gjatë matjes së dënimit ka pasur parasysh dhe vlerësuar gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe si rezultat i këtij vlerësimi ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimin ndërsa në anën tjetër mbrojtja në ankesë nuk ka argumentuar me ndonjë provë konkrete pretendimet të cilat kishin për të arsyetuar një pretendim të tillë ankimor, andaj duke qenë se i akuzuari gjeneron të ardhurat personale nga të cilat mban vetën dhe nënën e tij, e duke marrë parasysh edhe mënyrën e ekzekutimit të dënimit të përcaktuar si në dispozitiv, kjo

gjykatë vlerëson se ky dënim nuk do të ndikon në rrezikimin e kryerjes së obligimeve të domosdoshme familjare për atë dhe personin e varur nga ai.

Nga arsyet e lartcekura, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**PAKR.nr.264/2024, datë 29.05.2024**

**Bashkëpunëtoreshë Profesionale, Anëtarët e kolegjit,**

**Kryetare e kolegjit,**

**Gresë Latifi**

**Vaton Durguti**

**Afërdita Bytyçi**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Zyhdi Haziri**

\_\_\_\_\_